



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

**Raportimi në Komisionin për Ekonominë dhe Financat - Veprimtaria e AMF-së gjatë vitit 2019**

*E nderuara Kryetare e Komisionit,  
Të nderuar Zonja e Zotërinj deputetë, anëtarë të Komisionit,*

Në fillim të fjalës time, dua t'ju falënderoj edhe njëherë për votëbesimin në miratimin e kandidaturës sime në drejtim të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Raporti i paraqitur për vitin 2019 prezanton punën e kryer nga Autoriteti në përmbushje të detyrimeve ligjore, si dhe kërkesave të vendosura nga Kuvendi në rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së AMF-së. Ky raport i përket pjesërisht edhe punës sime, duke qënë se kam mbajtur pozicionin e Kryetarit të Bordit prej shtatorit 2019.

Duhet thënë, që ky raportim vjen në një moment shumë të ndryshëm nga viti 2019 për shkak të pandemisë COVID-19. Po ndalem me pak fjalë tani në fillim dhe pastaj në fund të fjalës do të përmend disa prej masave kryesore që ne mendojmë do të jenë drejtimet për vitin në vazhdim.

Situata pandemike pati efektet e saj edhe në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit. Tregu i sigurimeve ishte më i ndikuar nga pandemia, me një rënie në masën 33% të primeve të shkruara bruto, për periudhën 13 mars deri në fund të muajit prill, por me rihapjen ka nisur rikuperimi. Kjo reflektohet edhe në shifrat e 6-mujorit për primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve, ku rënia për periudhën janar-qershor 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë është rreth 6.5%.

Pandemia solli edhe një rritje të numrit të mjeteve të pasiguruara, në afro 22%, janë rreth 136 mijë mjete, shifër që përbën një risk sistemik për Fondin e Kompensimit dhe për gjithë tregun e sigurimeve. Kostot e krijuara për këtë fond nga mjetet e pasiguruara transferohen tek mbajtësit e rregullt të policave të sigurimit. Për këtë qëllim, i kemi propozuar Ministrisë së Brendshme hartimin e një plani veprimi të përbashkët për uljen e mjeteve të pasiguruara.

Për të kaluar në vitin 2019, në tërësi, tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, tregu i sigurimeve, tregu i fondeve të investimeve, tregu i kapitaleve dhe tregu i pensioneve private vullnetare vijuan rritjen. Në

fund të vitit 2019, totali i aktiveve në këto tregje u rrit me 6.7%, duke arritur në 108.8 miliardë lekë, ose 6.5% e PBB-së, përkundrajt 6.2% që ishte në vitin 2018.

*Në vijim, po ndalem me detaje në zhvillimet në tregjet nën mbikëqyrje.*

Totali i aktiveve në tregun e sigurimeve në fund të vitit 2019 arriti në rreth 38.7 miliardë lekë, me një rritje prej 22.5%, krahasuar me fundin e vitit 2018.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto arriti në 17.62 miliardë lekë, me një rritje prej 4.1% krahasuar me vitin 2018. Sa i përket strukturës së tregut, sigurimet e Jo-Jetës mbeten dominuese, në masën rreth 93%. Po ashtu edhe sigurimi i detyrueshëm, i cili zë 63.7% të totalit të tregut, kundrejt 36.3% që ka sigurimi vullnetar.

Totali i dëmeve të paguara bruto, në vitin 2019, arriti në 6.38 miliardë lekë ose rreth 8.6% më pak se në vitin 2018. Duhet sqaruar këtu se kjo ulje vjen për shkak të një dëmi të paguar në portofolin e zjarrit në vitin 2018, rreth 1.1 miliardë lekë, si edhe i dëmeve të paguara për Fondin e Kompensimit, që janë realizuar më së shumti gjatë vitit 2018.

Raporti dëme/prime neto në sigurimin (Jetë dhe Jo-Jetë) arriti në masën 37.1%, i pandryshuar krahasuar me vitin 2018, ndërsa raporti agregat i dëmeve të tregut (Jetë, Jo-Jetë dhe dëme Fond Kompensimi) arriti nivelin 41.4%, nga 42% që ishte për vitin 2018.

Tërmetet e shtatorit dhe nëntorit ishin ngjarjet madhore që shënjuan vitin 2019 përsa i përket tregut të sigurimeve. Autoriteti ka mbikëqyrur me kujdes situatën, duke kërkuar raportim nga shoqëritë me frekuencë ditore dhe në vijim monitorimi është kryer me bazë javore.

Bazuar në vlerësimet e deritanishme, vlera e kërkesave për dëmshpërblim arriti nivelin 475 milionë lekë për ngjarjen e 21 shtatorit dhe rreth 3.65 miliardë lekë për ngjarjen e 26 nëntorit. Pra, totali i kërkesave për dëmshpërblim për dy tërmetet e vitit 2019 është 4.12 miliardë lekë. Referuar numrit të dëmeve të raportuara, në linjë me pronat e siguruara, vihet re, që rreth 85% e tyre i përkasin të siguruarve, të cilët kanë siguar pronën për efekt kredie, ndërsa pjesa tjetër janë prona të siguruara në mënyrë vullnetare. Pagesa e dëmeve financiare të ndodhura nga dy ngjarjet e tërmetit është ndarë me shoqëritë e sigurimit në vend dhe shoqëritë e risigurimit. Bazuar në kontratat e risigurimit në fuqi për vitin 2019, për secilën ngjarje, vlera e dëmeve që pritet të paguhet nga tregu i sigurimeve arrin deri në 220 milionë lekë, ndërsa diferenca pritet të paguhet nga shoqëritë e risigurimit. Cilësia e risiguresve që mbulojnë shoqëritë e sigurimit është minimalisht A+, edhe pse kërkesat rregullore janë për një vlerësim BBB, duke garantuar një cilësi të lartë risigurimi. Ngjarjet e tërmetit nxorën në pah domosdoshmërinë e zgjerimit të mbulimit të sigurimit të pronës, duke qenë se afro 2.5% e banesave kanë një mbulim të tillë. Pas dy katastrofave natyrore, Bordi i Autoritetit vendosi rritjen me 34.4% të provigjoneve teknike, krahasuar me vitin 2018, që përbën rritjen më të madhe të realizuar ndonjëherë ndër vite. Praktikisht, e bën tregun të mirëprovigjunuar dhe jep mundësi të plota për të përballuar shlyerjen totale të dëmeve.

Autoriteti vijoi monitorimin e procesit të pagesave të prapambetura të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit. AMF bëri pjesë të raportimeve periodike mujore kopjet e pagesave të dëmeve Fond Kompensimi, të cilat tashmë administrohen edhe nëpërmjet Sistemit Elektronik të Dëmeve të Byrosë. Sa i përket akumulimit të detyrimeve në vite, Autoriteti shqyrtoi raportin e shoqërisë audituese ndërkombëtare mbi veprimtarinë e Byrosë Shqiptare të Sigurimit për periudhën 2001-2017 dhe të gjitha gjetjet po ndiqen në vazhdimësi. Gjatë vitit 2019 u paguan rreth 604 milionë lekë dëmshpërblime me objekt Fondin e Kompensimit. BSHS i raporton tashmë pagesat e kryera në mënyrë periodike mujore në AMF.

Në lidhje me tregun e sigurimeve, ka nisur zbatimi i projektit të asistencës të Bankës Botërore, i cili do të mbështesë Autoritetin në drejtim të rritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse. Konkretisht, komponenti i projektit për tregun e sigurimeve ka të bëjë me zhvillimin e një udhërrëfyese për zbatimin e regjimit të *Solvency II*, përgatitjen e një metodologjie mbikëqyrëse e analizuere për treguesit e riskut në sigurime, përmirësimin e kapacitetit mbikëqyrës të AMF-së për të vlerësuar qëndrueshmërinë dhe vlefshmërinë e modelit të biznesit të kompanive të sigurimeve, si edhe realizimin e trajnimeve për përmirësimin e aftësive të stafit të AMF-së.

Gjatë vitit 2019, licencimi i një shoqërie për të ushtruar veprimtarinë e sigurimit të Jetës e rriti numrin e shoqërive aktive në 12, nga të cilat 8 ushtrojnë veprimtarinë në sigurimin e Jo-Jetës dhe 4 në atë të Jetës.

Përsa i përket ndryshimeve të pritshme ligjore, projektligji “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” po shqyrtohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi iu nënshtrua konsultimeve me Shoqatën e Siguruesve dhe përfaqësues të Komisionit të Ekonomisë të Kuvendit në fund të vitit të kaluar.

**Tregu i fondeve të investimeve** ka vijuar rritjen, si në strukturë, edhe në shifra. Vlera neto e aktiveve të fondeve të investimit në fund të vitit 2019 arriti në 66.79 miliardë lekë, me një rritje prej 1% krahasuar me vitin 2018. Ky është tregu më i madh nën mbikëqyrjen e AMF referuar vlerës së aktiveve, sa 4% e PBB-së, njëkohësisht tregu i dytë më i madh financiar në vend, pas tregut bankar.

Gjatë vitit 2019, edhe në bazë të rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë, Autoriteti ka pasur në vëmendje vlerësimin e elementëve të veçantë të transparencës me investitorët e fondeve të investimeve, duke i informuar në lidhje me kontratën dhe marrëdhënien juridike në të cilën ata po investojnë. Në këtë kuadër, AMF ka kryer inspektim pranë të gjitha shoqërive administruese, të cilat administrojnë fonde investimi.

Tregu u zgjerua me licencimin e një shoqërie administruese të Fondit të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, si edhe miratimin e një Fondi Investimi. Në fund të vitit 2019, në tregun e fondeve të investimit ushtruan aktivitetin e tyre pesë fonde investimi të administruara nga katër shoqëri administrimi.

Në vitin 2019, totali i aktiveve neto të **fondeve të pensioneve private vullnetare** arriti në mbi 2.9 miliardë lekë, me një rritje prej afro 27%, krahasuar me vitin 2018. Edhe numri i anëtarëve në këto fonde pësoi rritje. Megjithatë, vlera neto e aseteve të këtij tregu është në masë të papërfillshme kundrejt PPB-së (0.2%).

**Tregu i kapitaleve**, edhe gjatë vitit 2019, përbëhej nga tregu i titujve të Qeverisë dhe tregu i Obligacioneve të Emetuara me Ofertë Private. Ende mbeten për t'u emetuar instrumentet e tjera financiare, si obligacionet korporative, apo aksionet. Listimi dhe tregtimi i këtyre instrumenteve financiare tashmë mund të realizohet nëpërmjet Bursës Shqiptare të Titujve.

Vlera totale e tregimit në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE për vitin 2019 arriti në rreth 1.47 miliardë lekë, ku kanë dominuar transaksionet e kryera midis bankave për llogari të tyre dhe për llogari të investitorëve institucionalë. Gjatë vitit 2019 u licencua shoqëria “Regjistri Shqiptar i Titujve” (ALREG) për kryerjen e funksionit të klerimit dhe shlyerjes së titujve joqeveritarë që tregtohen në Bursë. Zhvillimi i tregjeve të kapitalit në Shqipëri mbetet ende sfidë.

Në lidhje me **edukimin financiar dhe mbrojtjen e personave të siguar dhe investitorëve**, edhe gjatë viti 2019 vijuan aktivitetet informuese, përmes orëve të hapura në universitetet publike dhe private, organizimi i praktikave mësimore pranë AMF dhe subjekteve nën mbikëqyrje, si edhe organizimi i konferencës së dytë kombëtare për “Edukimin Financiar”. Në javën e parë të muajit tetor, AMF në bashkëpunim me shoqatat profesionale dhe aktorët kryesorë të tregjeve në vend, zhvilloi “Javën e Investitorit”, pjesë e nismës botërore të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), si një javë sensibilizimi për rritjen e edukimit financiar në tregun e kapitaleve dhe fondeve.

Gjatë vitit 2019, është zhvilluar më tej infrastruktura e teknologjisë së informacionit, me përdorimin e sistemeve të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese. Kështu është ngritur sistemi i raportimit *online* për tregun e fondeve të pensioneve dhe të investimeve dhe po vijon puna për ta bërë atë funksional. Është përmirësuar gjithashtu regjistri i dëmeve dhe është integruar me sistemet e dëmeve pranë shoqërive të sigurimit. Po ashtu është realizuar raportimi në kohë reale i policave të sigurimit të minatorëve, si dhe të pasagjerëve në udhëtim.

*Të nderuar deputetë,*

Pandemia COVID-19, në varësi të shtrirjes së efekteve në tregjet nën mbikëqyrje, do të përcaktojë sfida domethënëse për Autoritetin gjatë pjesës së mbetur të këtij viti, por edhe në vazhdim. Edhe pse në fazën e parë tregjet i rezistuan pasojave, është ende herët për të parashikuar ndikimin e plotë dhe ndërhyrjet që mund të kërkohen në planin rregullator. Autoriteti mori disa masa për të garantuar mirëfunksionimin e tregjeve dhe mbrojtjen e personave të siguar dhe investitorëve. Një prej tyre ishte pezullimi i shpërndarjes së dividendit për shoqëritë e sigurimit, për të ruajtur kapitalet brenda sistemit.

Autoriteti do të vijojë të monitorojë zhvillimet në tregjet nën mbikëqyrje, ndërsa mbetet i angazhuar për hartimin e protokolleve të qarta për menaxhimin e krizave, me qëllim amortizimin e pasojave të tyre, shoqëruar me fleksibilitetin e vendimmarrjes në situata emergjence, në linjë edhe me rekomandimet e autoriteteve evropiane, EIOPA dhe ESMA.

Gjithashtu, AMF synon të përmirësojë planet e vazhdimësisë së biznesit për subjektet nën mbikëqyrje, duke arritur njëkohësisht një përputhshmëri të lartë me standardet ndërkombëtare të sigurimeve dhe të tregjeve të kapitalit.

Referuar mbikëqyrjes, fokusi kryesor është që të kalojmë në një mbikëqyrje të plotë me bazë rreziku, duke i përqendruar resurset dhe vëmendjen aty ku risqet janë më të larta. Në planin afatmesëm synojmë të arrijmë standardet e aplikuara në BE, përmes regjimit të Solvency II. Ky objektivi synohet të arrihet ndër të tjera duke vlerësuar nevojat për ndërhyrje në ligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” me asistencën teknike të Bankës Botërore. Në varësi të rekomandimeve dhe analizës së ekspertëve të Bankës Botërore mund të lindë nevoja për disa ndryshime, qoftë në ligjin “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, qoftë në ligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Sfidë tjetër sa i përket asaj që ka rezultuar nga pandemia është nevoja për zhvillimin dhe diversifikimin e tregjeve për të përballuar më mirë goditjet, veçanërisht në tregun e sigurimeve, përmes produkteve të reja, që do të ulnin varësinë e tregut ndaj sigurimit të detyrueshëm TPL.

Sfidë tjetër në situatën që po kalojmë, është digjitalizimi. Arritja në një regjim pa letra, për raportimin dhe inspektimin, do të shtonte efikasitetin e Autoritetit në mbikëqyrje, duke orientuar më mirë burimet njerëzore. Gjithashtu krijimi i e-shërbimeve do të sillte ulje të kostove dhe heqjen e barrierave për qytetarët.

Edhe në zbatim të rekomandimeve të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, lidhur me forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit, do të vijojë trajnimi i stafit teknik, duke iu përshtatur nevojave për rritjen e ekspertizës profesionale të tyre. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e aftësive për menaxhimin e skenarëve të krizave në tregjet nën mbikëqyrje.

Falënderit!